

MBI
AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË
BASHKINË KAMËZ, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar të kryer në Bashkinë Kamëz, me objekt: “Mbi aktivitetit ekonomik e financiar dhe kontrollin e brendshëm, zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet me fonde publike për mallra e shërbime, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj.”, për llojin e auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.09.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 180, datë 31.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 803/5, datë 31.12.2013, i ka rekomanduar z. Xhelal Mziu, Kryetar i Bashkisë Kamëz Tiranë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Drejtoria e Financës të marrë masa për ndjekjen dhe arkëtimin e vlerës 500,000 lekë, e cila përfaqëson rekomandimet e pazbatuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së për dy subjekte në objektin “Ndërtimi i rrugës Mërkuri”.

2. Bashkia Kamëz në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2014 të marrë masa për rishikimin me grup pune të normativave të karburantit sipas llojeve të automjeteve dhe gjeneratorit të bashkisë, ndjekja dhe evidentimi korrekt i tyre me qëllim pasqyrimin e saktë të konsumit të tyre.

3. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Shërbimeve të parashikojë dhe të likuidojë faturat për investimet e kryera dhe të marra në dorëzim, si dhe shpenzimeve operative të prapambetura, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 4 datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”.

4. Klubi i futbollit të hartojë strukturën organizative në funksion të ekipit të futbollit, të ndihmojë në hartimin dhe lidhjen e kontratave me futbollistët dhe t’i paraqesë për miratimin ato në Këshillin e Bashkisë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7961, datë 11.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, *trajtuar faqen 17-21 Raport Auditimit*.

5. Drejtoria e Financës të bëjë hyrje studimin për “Për fizibilitetin dhe Projektzbatimin e fazës së parë të Ujshellsit Kamëz” me vlerë 8,772,000 lekë, likuiduar prej vitit 2012, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

6. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për planifikimin real të taksave e tarifave vendore, bazuar në të dhënat që disponon Bashkia dhe realizimeve të mëparshme, duke i programuar ato hollësisht sipas llojit të biznesit dhe detyrimeve përkatëse.

7. Drejtoria e Taksave Vendore të marrë masa për, hartimin e planit vjetor në ushtrimin e kontrolleve në drejtimit e përcaktuara, në zbatim të pikës 10 “Kontrolli tatimor”, udhëzimit të përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”.

8. Drejtoria e Taksave Vendore të njoftojë të gjithë abonentët familjarë dhe jo familjarë, mbi detyrimet që ata kanë për taksat dhe tarifat vendore, në zbatim të nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe të mbajë evidencë për ecurinë e përmbushjes së detyrimit në një regjistër të veçantë, me qëllim aplikimin e masave të tjera shtrënguese në rast mos përmbushje të tyre.

9. Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe zyrën e Financës, të kërkojë në rrugë administrative e ligjore arkëtimin e detyrimeve të debitorëve për 846 raste me një vlerë prej 42,974,000 lekë.

10. Drejtoria e Taksave vendore të marrë masa organizative dhe ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e taksave që arkëtohen nga njësitë e tjera publike si ZVRPP Tiranë etj, duke kërkuar e bërë rakordime periodike dhe ushtrimin e të drejtës ligjore për të ndikuar mbi agjentët tatimor me qëllim rritjen e të ardhurave.

11. Drejtoria e Taksave Vendore të nxjerrë njoftim për vlerësimet në e 846 debitorëve subjekte të biznesit të madh, të vogël dhe institucione shtetërore në fund të gjashtë mujorit të parë të vitit 2013, për mos likuidimet në afat të detyrimeve për taksat e tarifat e pa likuiduara në zbatim të nenit 70, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

12. Bashkia Kamëz të marrë masa për tu kryer inventarizimin fizik të asetëve në pronësi me qëllim përdorimin ose dhënien me qira, si dhe të parashikojë fonde për të bërë regjistrimin e tyre, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” etj.

13. Bashkia Kamëz t’i kërkojë ALUIZNI-¹ Tiranë, që pas përfundimit të procesit të legalizimit të evidentojë parcelat e tokës të klasifikuara shtet, me qëllim përfshirjen e tyre në listën e inventarit të pronave të bashkisë në zbatim të VKM përkatëse.

14. Të përditësohet rregullorja aktuale e bashkisë, në të cilën të përcaktohen qartë detyrat funksionale të çdo zyre e punonjësi të institucionit, si dhe të drejtat e tyre në ushtrimin e detyrës, si dhe duke u trajtuar problematika në mbledhjen e radhës të Këshillit me qëllim miratimi i saj. Ndryshimet të bëhen duke u mbështetur në konstatimin se në rregulloren aktuale nuk janë përfshirë disa sektorë të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, apo nuk ka një strukturë të miratuar për menaxhimin e asetëve të bashkisë etj.

15. Të rishikohet struktura aktuale e bashkisë duke përshtatur përgjegjshmërinë menaxheriale të punonjësve kryesorë, hartimin e programeve dhe procedurave të administrimit, dokumentimit të aktiveve, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010.

16. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të mos pranojë e shqyrtojë kërkesa për leje shfrytëzimi, përdorimi për subjektet ndërtuese, pa pasur më parë vërtetim të shlyerjes së detyrimeve nga Zyra e Financës dhe nga INUV-i i Bashkisë.

17. Bashkia Kamëz, të heq nga skema e ndihmës ekonomike për mungesë dokumentacioni 14 përfitues, si dhe të ngrihet grup pune me përbërje nga auditi i bashkisë, zyra juridike dhe ajo e financës për evidentimin e të gjithë individëve të trajtuar me ndihmë ekonomike, të cilët kanë mangësi në dokumentacion, për plotësimin e tyre.

18. INUV të marrë masa për arkëtimin e 29 gjobave të vendosura në vitet 2011, 2012 dhe 2013 me vlerë 13,350 mijë lekë.

19. Bashkia Kamëz në bashkëpunim institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë dhe Ministrisë së Brendshme, të marrë masa për organizimin, funksionimin, rekrutimin e punonjësve, në strukturën e Policisë Bashkiake, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8335 datë 23.4.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e policë së bashkisë e komunës”.

20. Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të evidentoj, vlerësojë dhe kërkojë të arkëtimin për detyrimet e taksave dhe tarifat vendore vitin 2012-2013, si dhe të hartohen njoftim vlerësimet për vlerën 6,387,784 lekë për 96 subjekte të biznesit të vogël, në zbatim të nenit 70/3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

B. MASA SHPERBLIM DEMI

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit, arkëtimi i vlerës **15,043,554 dëm ekonomik**, si më poshtë:

1. Vlera 5,694,553 lekë, takse ndikimit ne infrastrukture, nga Shoqëria X sh.p.k., pasi ka paguar më pak si rezultat i reduktimit te taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 2.5 % në 1.5 %, për objektin “Park Logjistik Industrial”.
2. Vlera 4,681,065 lekë, për 102 punonjës të administratës, e cila përfaqëson pagesa për punë jashtë kohës normale gjatë vitit 2012 dhe 2013, në kundërshtim me pikën 1/2 të udhëzimit MF nr. 16 datë 20.07.2011 dhe pikën 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011.
3. Vlera 937,050 lekë gjithsej, z. XH.M., V.D., Q.Q. dhe T.K. e cila përfaqëson pagesa të kryera për trajnime jashtë vendit, në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 pika 3 dhe 4.
4. Vlera 905,680 lekë, nga Shoqëria X sh.p.k., i shpallur fitues në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare lagje nr. 4”.
5. Vlera 554.420 lekë, nga Shoqëria X sh.p.k., e cila përfaqëson pagesë për punime të pakryera në tenderin me objekt “Ndërtim i rrugës Albanet”.
6. Vlera 486.061 lekë, nga Shoqëria X sh.p.k., takse e ndikimit ne infrastrukture, nga pasi ka arkëtuar më pak (300.480 lekë vlera e penalizmit + 185.581 lekë vlera e llogaritjes gabim të taksës së ndikimit në infrastrukturë) për objektin “Godinë banimi dhe shërbimi 2,6,8kt + 1kt nëntokë”.
7. Vlera 471,744 lekë nga Shoqëria X sh.p.k., pagesë e kryer për dy herë për të njëjtin objekt, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
8. Vlera 264,340 lekë, nga Shoqëria X sh.p.k., e cila përfaqëson pagesë për punime të pakryera në tenderin me objekt “Shtese Rruga Kryqezim Kamez – Laknas Skënderbeu”, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.
9. Vlera 231.452 lekë, takse e ndikimit ne infrastrukture, nga Shoqëria X sh.p.k., pasi ka paguar më pak (për llogaritje gabim taksa e ndikimit në infrastrukturë) për objektin “Godinë banimi e shërbimi 2,5,6,7,8kt +1 kat nëntokë”.
11. Vlera 223.540 lekë, nga Shoqëria X sh.p.k., e cila përfaqëson pagesë për punime të pakryera në tenderin në objektin: Ndërtim i rrugës Kongresi i Manastirit,
12. Vlera 196,000 lekë, 80 punonjësve të administratës, ose nga 2,450 leke secila, e cila përfaqëson pagesa të kryera për festën e 8 Marsit 2013 në kundërshtim me pikën 1. b t VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”.
13. Vlera 108,441 lekë nga Shoqëria X sh.p.k., që përfaqëson pagesa të kryera për punë të pakryer, në marrjen në dorëzim të pemëve, ne kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 154 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës” i ndryshuar dhe kontratave individuale të punës, kërkohet që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652 datë 31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

“Ndërprerje të Kontratës së punës” për:

1. **V.V.** me detyrë drejtore e Burimeve Njerëzore, për shkak se:

- Ka lejuar emërimin e 19 emërimet policëve bashkiakë në kushtet e mungesës së formimit në Akademinë e Policisë etj, si dhe nuk ka lidhur kontratat e punës me afat mbi tre vjet, në kundërshtim urdhrin e përbashkët të Ministrisë Pushtetit Vendor dhe Ministrisë Rendit Publik nr. 1530, datë 7.4.2003 dhe nr. 823, datë 11.04.2003 dhe Rregulloren TIP dalë në zbatim të saj.
- Ka kërkuar dhe ka lejuar kryerjen e pagesave për punë jashtë kohës normale, të cilat i kanë shkaktuar buxhetit të bashkisë dëm ekonomik në shumën 4,681,065 leke, për vitin 2012 dhe 7-mujorin 2013, në kundërshtim me pikën 1/2 të UMF nr. 16 datë 20.02.2011 si dhe me pikën 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011.
- Ka lejuar një punonjës të kryejë njëkohësisht detyra në kushtet e konfliktit të interesit në kundërshtim me nenin të ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

“Vërejtje me Paralajmërim”, për

- 2. A.D.** me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Kamëz, në cilësinë e kryetarit të vlerësimit të ofertave.
 - 3. V.D.** me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Kamëz, në cilësinë e kryetarit të vlerësimit të ofertave.
 - 4. Atli Hoti** me detyrë Drejtor i Zyrës Juridike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.
 - 5. Arbër Tola** me detyrë arkitekt specialist në Urbanistike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.
- Kanë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, me parregullsi në dokumentacionin ligjor kualifikues, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* ndryshuar, neni 24/1.

6. V.S. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës, pasi:

- Ka lejuar kryerjen e pagesave për punë jashtë kohës normale , të cilat i kanë shkaktuar buxhetit të bashkisë dëm ekonomik në shumën 4,681,065 leke, për vitin 2012 dhe 7-mujorin 2013, në kundërshtim me pikën 1/2 të udhëzimit MF nr. 16 datë 20.07.2011 si dhe me pikën 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 *“Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”* .
- ka lejuar kryerjen e pagesave për trajnime jashtë shtetit, aktivitet social kulturor etj, të cilat i kanë shkaktuar dëm buxhetit të bashkisë në shumën 1,100,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 *“Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”* etj.
- Ka lejuar në pesë raste kryerjen e shpenzimeve për blerje me vlera të vogla të pajustificuara dhe me mungesa në dokumentacion, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* dhe me udhëzimin nr. 30, datë 20.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

7. SH.H. me detyrë ish drejtore e Burimeve Njerëzore dhe aktualisht drejtore e Shërbimeve Publike, pasi:

- Ka kërkuar dhe ka lejuar kryerjen e pagesave për punë jashtë kohës normale , të cilat i kanë shkaktuar buxhetit të bashkisë dëm ekonomik në shumën 4,681,065 leke, për vitin 2012 dhe 7-mujorin 2013, në kundërshtim me pikën 1/2 të udhëzimit MF nr. 16 datë 20.07.2011 si dhe me pikën 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 *“Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”* .
- Ka plotësuar me mangësi fletë udhëtimet e automjeteve të bashkisë, në kundërshtim me ligjin me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 *“Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionaret publik dhe nëpunësve civile”* etj.
- Nuk ka administruar inventarin e mjeteve në përdorim, jashtë përdorimit etj, për taksën e regjistrimit të Automjeteve,, në kundërshtim me neni 7 dhe 61 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 etj.

- Nuk ka ushtruar kontroll për arkëtimin e tarifës së parkimit për automjetet taksi në kundërshtim me VKB nr. 72, datë 07.5.2012.

8. H.G.J. me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit,

9. F.R. me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit pasi:

- Kanë lejuar në gjashtë raste dhënien dhe miratimin e lejeve të ndërtimit në mungesë të dokumentacionit, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar etj, *trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

- ka bërë llogaritje të gabuar të pagesave që lidhen me dhënien e lejeve të ndërtimit në katër objekte, duke shkaktuar dëm ekonomik në shumën 6,412,066 lekë, në kundërshtim me nenin 51 të ligjit të ligjit 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar dhe vendimin përkatës të këshillit të bashkisë, *trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar Auditimit.*

10. M.A. specialiste e pagave, në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve vogla, pasi:

- Ka lejuar kryerjen e pagesave për punë jashtë kohës normale, të cilat i kanë shkaktuar buxhetit të bashkisë dëm ekonomik në shumën 4,681,065 leke, për vitin 2012 dhe ë-mujorin 2013, në kundërshtim me pikën 1/2 të udhëzimit MF nr. 16 datë 20.07.2011 si dhe me pikën 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”.

- Në 9 raste me vlerë 11 milion gjithsej, ka zhvilluar procedurë të drejtpërdrejtë prokurimi, ka vepruar duke copëzuar fondet për artikuj dhe shërbime të së njëjtës natyrë, në kundërshtim me nenin 28, 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar.

11. SH.XH. me detyrë specialiste e financës, në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve vogla dhe nxjerrjet jashtë përdorimit, pasi:

- Ka krye veprime me parregullsi e mangësi në dokumentacionin e blerjeve me vlera të vogla në 21 raste, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar.

- Në 9 raste me vlerë 11 milion gjithsej, ka zhvilluar procedurë të drejtpërdrejtë prokurimi, ka vepruar duke copëzuar fondet për artikuj dhe shërbime të së njëjtës natyrë, në kundërshtim me nenin 28, 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar.

- Ka kryer nxjerrjen jashtë përdorimit të disa pajisjeve elektronike, me parregullsi dhe mangësi në dokumentacion në kundërshtim me ligjin nr. 10.296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

12. A.P. me detyrë arkëtare dhe magazinierë e bashkisë, pasi:

- Nuk ka respektuar gjendjen në lekë, limitin të arkës, në kundërshtim me VKM-së nr. 290, datë 14.6.1993 “Për limitin e arkës”, dhe mosplotësimin e listë pagesave me të gjitha ekstremitetet.

- Ka lejuar kryerjen e pagesave për udhëtim e dieta, qira objektësh etj, me lekë në dorë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për kryerjen e pagesës së dietave për 25 sportistë me vlerën 50,000 lekë, me mungesa në dokumentacion shoqërues, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

- Nuk ka administruar dokumentacionin e nevojshëm në konsumin e karburantit, për pranimin e fletudhëtimeve të parregullta për automjetet të bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Nuk ka bërë hyrje të projektit “Studim fizibiliteti dhe Projekt Zbatim i fazës pare Ujsjellsi Kamez” për vlerën 8,772,000 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

13. B.LL. me detyrë drejtor i taksave dhe tarifave vendore, pasi:

- Ka lejuar funksionimin e 708 subjekte të cilëve u janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, por që nuk janë regjistruar në QKR, në kundërshtim me nenin 40, pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

-Për mos mbajtjen e regjistrit themelor (progresiv) të tatim paguesve të subjekteve të biznesit të madh, vogël, institucioneve shtetërore dhe abonentëve familjarë, si dhe për mos hapjen e kartelave personale për të gjitha detyrimet mbi taksat e tarifave vendore, në referim të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, dhe pika 9, e udhëzimit të MF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007.

- Ka lejuar funksionimin e subjekteve të cilët janë kaluar me status pasiv dhe që rezultojnë debitorë, nuk ka bërë evidentimin dhe arkëtimi i këtyre vlerave në momentin e krijimit të tyre ose në periudhat e mëvonshme, të cilat rezultojnë aktualisht të ardhura këto të munguara në buxhetin e bashkisë, në kundërshtim me nenin 45 etj, të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008.

- Nuk ka aplikuar sanksionet për mos likuidim në afat të detyrimeve, nuk dokumentohet njoftimi i subjekteve me njoftim vlerësim, në kundërshtim me neni 1ë, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, nenin 114 etj, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008

- Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për mos likuidimet, nuk u janë dërguar njoftime bankave të nivelit të dytë për subjektet debitorë etj, në kundërshtim me nenin 90, 91 etj, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar.

14. E.D. me detyrë specialiste e Urbanistikës,

15. Q.Ç. me detyrë specialiste e Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

- Kanë lejuar kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE, që nuk plotësonin kriteret në tenderin me objekt *“Ndërtim i shkollës 9 vjeçare lagje nr. 4”*, në kundërshtim me neni 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* ndryshuar dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

“Vërejtje me Shkrim”, për:

16. D.B. me detyrë llogaritare e magazinës, pasi:

- Nuk ka administruar dokumentacionin e nevojshëm në konsumin e karburantit, për pranimin e fletudhëtimeve të parregullta për automjetet të bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

- Nuk ka bërë hyrje të projektit *“Studim fizibiliteti dhe Projekt Zbatim i fazës parë Ujësjiellësi Kamez”* për vlerën 8,772,000 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

- Ka lejuar daljen e disa artikujve nga magazina në mungesë të justifikimit të tyre me normativat përkatëse.

- Ka kryer nxjerrjen jashtë përdorimit të disa pajisjeve elektronike, me parregullsi dhe mangësi në dokumentacion në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

17. S.R. me detyrë kryeinspektor i policisë bashkiake, pasi:

- Nuk ka vepruar për kualifikimin dhe trajnimin e punonjësve të policisë bashkiake, në kundërshtim me ligjin nr. 8335 datë 23.4.1998 *“Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë e komunës”*.

- Nuk ka arkëtuar plotësisht gjokat e vendosura në vitet 2011, 2012 dhe 2013, në kundërshtim me nenin 22 të Rregullores brendshme të bashkisë.

18. P.K. me detyrë kryeinspektor i INU, pasi:

- Nuk ka arkëtuar 29 gjoka me vlerë 13,350,000 lekë, në kundërshtim me nenin 22 të Rregullores brendshme të bashkisë.

19. A.XH. administrator i gjeneratorit, pasi nuk ka mbajtur dhe evidentuar me dokumentacion të rregullt kohën e punës të gjeneratorit, konsumin e karburantit dhe shoqërimin e tij me dokumentacionin e nevojshëm justifikues.

20. E.M. me detyrë specialist preventivues i urbanistikes, për mangësi dhe parregullsi në dokumentacionin e shërbimeve me vlera te vogla për vitin 2011,2012 dhe 2013, kanë munguar dokumentet shoqëruese si skica , fotografime, përmasime etj, në kundërshtim me ligjin nr. 10.296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

21. J.P. me detyrë përgjegjëse zyrës taksave vendore sipas ndarjes territoriale, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore,

22. A.L. inspektorë i taksave vendore sipas ndarjes territoriale, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore,

23. E.V. inspektorë i taksave vendore sipas ndarjes territoriale, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore,

24. G.B. inspektorë i taksave vendore sipas ndarjes territoriale, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore,

25. F.SH. inspektorë i taksave vendore sipas ndarjes territoriale, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, për:

- Për mos pagimin nga subjektet të hapësirave publike të zëna,

- Taksën e Biznesit të Vogël, për të cilin megjithëse paraqitet në rritje numri i subjekteve nga njëri vit në tjetrin, nuk rezulton me të njëjtat nivele niveli i arkëtimeve.

- Mos taksimin për tre vjet 3 detyrimin e taksës dhe tarifës vendore, për 96 subjekte me vlerë 6,382,284 lekë, e cila paraqitet si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenit 9, 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

- Mos planifikimin e taksës së reklamës, mungesës së regjistrimit të evidentimit të subjekteve që paguajnë taks reklame, mungesës së kontrolleve në terren për evidentimin e subjekte që kanë reklamë etj.

- Ka lejuar funksionimin e 708 subjekte të cilëve u janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, por që nuk janë regjistruar në QKR, në kundërshtim me nenin 40, pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

Për mos mbajtjen e regjistrimit themelor (progresiv) të tatim paguesve të subjekteve të biznesit të madh, vogël, institucioneve shtetërore dhe abonentëve familjarë, si dhe për mos hapjen e kartelave personale për të gjitha detyrimet mbi taksat e tarifave vendore, në referim të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, dhe pika 9, e udhëzimit të MF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007.

26. H.P. me detyrë inspektore e abonentëve familjar, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pasi:

- Për Tarifën e Pastrimit nuk mbahet regjistër i veçantë për abonentët familjarë të cilët kanë detyrimin ligjorë për pagimin dhe arkëtimin e kësaj tarife, e cila aplikohet vetëm për abonentët familjarë që paraqiten në bashki për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, duke sjellë mos evidentim të saktë të detyrimit që lind nga kjo tarifë, vlera e detyrimit të arkëtuar dhe të mbetur, ndarë ky në vite, veprime në kundërshtim me nenin 4 dhe 3, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008

- Për Taksën bujqësore, nuk mbahet regjistër i veçantë për abonentët familjarë të cilët kanë detyrimin ligjorë për pagimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, e cila aplikohet vetëm për abonentët familjarë që paraqiten në bashki për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, duke sjellë mos evidentim të saktë të detyrimit që lind nga kjo taksë, vlera e detyrimit të arkëtuar dhe të mbetur, ndarë ky në vite, veprime në kundërshtim me nenin 4 dhe 3, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

- Tarifa e gjelbërimit, paguhet vetëm nga ato abonent që paraqiten në Zyrat e Gjendjes Civile apo Bashki, kurse pjesa tjetër nuk marrin një njoftim për masën e detyrimit duke sjellë mos evidentim të saktë të detyrimit që lind nga kjo tarifë; sa është vlera e detyrimit të arkëtuar dhe vlera e mbetur si detyrim i pa arkëtuar, veprime në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenin 32, të ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Nga Bashkia Kamëz janë pranuar e vënë në zbatim rekomandimet e KLSH dhe është dërguar Plan masash për zbatimin e tyre me shkresë të protokolluar në KLSH nr. 803/8 datë 22.01.2014, pra rezulton se **rekomandimet janë pranuar**, dhe janë në marrë masat për zbatimin e tyre.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Besim Bileri, Milo Pano, Ryisim Xhaja, Luan Kuka, Selman Hysa dhe Xhemal Luka, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT